



energjisë elektrike”, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e “draftlicencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 11, datë 23.2.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 23, DATË 24.6.2015, “PËR LICENCIMIN UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SHA”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 24.6.2015, “Për licencimin Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1/a bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Mark Molla.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 12, datë 23.2.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 22.12.2014 “PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS URA VAJGURORË”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 26, datë 22.12.2014, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Ura Vajgurore” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues teknik: Jolanda Gjordeni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi

VENDIM

Nr. 13, datë 23.2.2016

PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE DHE MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT UK DERI NË PËRFUNDIM TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT TË SHOQËRIVE UK

Në zbatim të nenit 14, germa “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke pasur në konsideratë periudhën kohore që u nevojitet njërive të qeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit, sipas reformës administrative territoriale,